

## **Komuna e Rahovecit: problemet kryesore dhe trendet buxhetore**

### **Hyrje**

1. Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën veri-perëndimore të Kosovës. Llogaritet t'i këtë afërsisht 276 km<sup>2</sup>. Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, kjo komunë ka 56.208 banorë.<sup>1</sup>
2. Komuna e Rahovecit gjatë tri viteve të kaluara ka mbajtur dy palë zgjedhje lokale. Në zgjedhjet e para të rregullta të zhvilluara në fund të vitit 2009, kryetar komune është zgjedhur Qazim Qeska si kandidat nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Pas 11 muajsh të ushtrimit të mandatit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, Qazim Qeska pati dhënë dorëheqje nga pozita e të parit të komunës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) shpalli mbajtjen e zgjedhjeve të reja për Komunën e Rahovecit më 18 dhjetor 2010. Zgjedhjet u zhvilluan në dy raunde. Në balotazh fitues doli Smajl Latifi nga AAK, i cili fitoi 53% të votave, ku për kundërshtar kishte Ibrahim Kryeziun nga LDK.
3. Kuvendi Komunal i Rahovecit përbëhet prej 31 përfaqësuesve nga parti të ndryshme, ku dhjetë prej tyre janë asamblistë të PDK, shtatë nga LDK, pesë nga AAK, katër nga AKR, një nga LDD, një nga PD dhe dy asamblistë janë nga Lëvizja Integrim dhe Bashkim. Anëtarët e KK të Rahovecit janë zgjedhur në zgjedhjet e nëntorit 2009, për dallim nga Kryetari i cili është zgjedhur në janar të 2011.
4. Komuna e Rahovecit njihet si lokalitet bujqësor. Kjo komunë vlerësohet për cilësinë e rrushit dhe verërave që prodhon. Prej vitit 1990 deri në vitin 1999, pjesë e Komunës së Rahovecit ishte edhe Malisheva.
5. Sipas një hulumtimi të Institutit GAP, i realizuar në vitin 2009, problemet më të mëdha me të cilat janë përballuar qytetarët e Rahovecit kanë qenë mungesa e energjisë elektrike, përqendrimi i

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: [http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

investimeve vetëm në qytet, mungesa e infrastrukturës shkollore si dhe vërshimet e shpeshta të lumenjve.<sup>2</sup>

## Problemet kryesore të Komunës së Rahovecit 2013

**1. Problemi i mungesës së ujit.** Komuna e Rahovecit furnizohet me ujë nga hidrosistemi i Radoniqit të Gjakovës dhe nga burimet nëntokësore. Në dy vitet e fundit, qyteti i Rahovecit ka pësuar reduktime të shpeshta të ujit, ku orari i furnizimit me ujë është një ose dy orë në ditë. Madje gjatë stinës së verës ka edhe lagje ku mbesin me ditë pa ujë të pijshëm. Banorët e lagjes “Rijet” në muajin gusht të këtij viti nuk kanë pasur ujë për dhjetë ditë. Gjithashtu, rreth 30 familje që jetojnë përgjatë rrugës “Xhevat Aladin Elshani”, kanë pasur ankesat e njëjta. Përveç lagjeve në qytet që ankohen për mungesë të ujit, probleme janë hasur edhe në disa fshatra siç janë Bratotinë, Dobidol, Polluzhë, Çifllak, etj. Ky problem është evidentuar dhe potencuar edhe në raportet e UNDP-së. Sipas këtyre raporteve, furnizimi i ujit nga ujësjellësi publik është mjaft problematik në Komunën e Rahovecit. Përqindja e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik, të cilat kanë furnizim të pakufizuar me ujë, është e ngjashme me mesataren e Kosovës, 41%. Njëzet e tre përqind kanë ndërprerje të furnizimit me ujë prej 1 deri në 4 orë në ditë, 30% prej 5 deri në 10 orë në ditë, kurse për 6% të tyre ndërprerjet zgjasin më shumë se 11 orë në ditë. Problemi më i madh në komunën e Rahovecit, sipas UNDP-se është cilësia e ujit të pijshëm nga ujësjellësi publik dhe shtypja e ulët e ujit.<sup>3</sup>

**2. Mungesa e kanalizimeve.** Disa vendbanime të kësaj komune përballen me mungesë të rrjetit të kanalizimeve dhe në disa vendbanime të tjera edhe për kundër ekzistimit të këtij rrjeti, ai është jo funksional. Kësisoj në fshatin Ratkoc është i shtrirë rrjeti i kanalizimit, por tani nuk është funksional. Në fshatin Drenoc, kanalizimi i ujërave të zeza ka nisur që nga viti 2011 dhe ende nuk ka përfunduar. Ngjashëm qëndron gjendja edhe në pjesën më të madhe në fshatin Senoc. Në këtë fshat nuk është i lidhur as ambulanca në sistemin të kanalizimit. Sipas raportit të

<sup>2</sup> Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Rahovecit. 2009. Fq 7.

<sup>3</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 134.  
Burimi:[http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Alb\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf)

USAID/DEMI, 38% e qytetarëve në Rahovec janë deklaruar të pakënaqur me gjendjen e kanalizimeve në vendbanimet e tyre.<sup>4</sup>

- 3. Problemi nga pickimi i rriqrave.** Instituti i Shëndetit Publik ka shpallë disa zona të Rahovecit si zona endemike të shkallës së lartë nga pickimi i rriqrave të cilat shkaktojnë infektimin me sëmundjen e etheve hemorragjike. Rreth 19 zona konsiderohen zona të përhapjes së rriqrave. Banorët e këtyre zonave kritikojnë autoritetet lokale dhe ato qendrore për neglizhencë në marrjen e masave në parandalimin e përhapjes së rriqrave.<sup>5</sup>
- 4. Përroi në Xërxë.** Në fshatin Xërxë, ekziston një përrua që ka një rrjedhë të gjatë rreth 5-6 km dhe me një thellësi 2 metër, gjë që për banorët e këtij fshati paraqet problem gjatë të reshurave. Përroska gjendet në mes hekurudhës dhe rrugës së vjetër të fshatit. Ky përrua në pjesën përfundimtare është i rrafshët dhe nga të reshurat ai vërshon duke shkaktuar kësisoj pasoja në ekonominë familjare.
- 5. Dëmtimi i shtratit të lumit Dullo dhe Drini i Bardh.** Komuna e Rahovecit përshkohet nga lumi Dullo dhe nga lumi Brini i Bardhë. Shtretërit e këtyre dy lumjaneve shfrytëzohet nga individ dhe kompani të ndryshme për nxjerrjen e zhavorrit, duke e dëmtuar kësisoj rrjedhën e lumjaneve. Problemi me i theksuar nga kjo haset në disa fshatra si Çiflag, Celinë, Dejë, Fortesë, Kromovik dhe Ronaj. Këta lumenj shfrytëzohen edhe për derdhjen e ujerave të zeza të qytetit dhe fshatrave përreth.

## Gjërat pozitive që duhet ruajtur dhe mirëmbajtur

- 1. Sahat Kulla.** Kjo kullë është ndërtuar në vitin 1791 nga Mehmet Pasha dhe konsiderohet emblemë e Komunës së Rahovecit. Prandaj, kjo duhet të ruhet nga degradimet dhe të investohet më tepër përreth kësaj zone, veçmas në gjelbërim, ndriçim dhe ulëse për qytetaret.
- 2. Vreshtaria.** Komuna e Rahovecit është e njohur për kultivimin e hardhive të rrushit dhe prodhimtarinë e verërave. Bashkëbiseduesit përgjithësisht në këtë komunë kanë kërkuar nga Komuna që kujdes i veçantë t'u kushtohet mirëmbajtjes së


<sup>4</sup> Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 21. Burimi: [http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen\\_Satisfaction\\_Report-Shqip.pdf](http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf)

kanaleve të ujitjes përgjatë tokave bujqësore dhe zonave ku janë të mbjella me rrush.

## Trendet Buxhetore në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit në vitin 2013 ka planifikuar buxhet prej 9.8 milion euro, ndërsa krahasuar me vitin 2010 buxheti i kësaj komune është rritur për 2 milionë euro. Të hyrat vetanake në vitin 2012 kanë qenë 800 mijë euro apo 16 mijë euro më shumë se në vitin 2010. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm <sup>6</sup> ka gjetur se komuna në 5 raste ka vazhduar kontratat e dhënies me qira të objekteve të komunës, subjekteve të cilat asnjëherë nuk kanë kryer obligimet.

Figura 1. Buxheti i Komunës së Rahovecit 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?rahovec/2013#/~ /rahovec>

<sup>6</sup> ZAP, Raporti I Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Rahovecit Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013,

<http://ëëë.institutigap.org/spendings/?rahovec/2013#/~ /rahovec>

Në bazë të grafikonit të mëposhtëm rreth ndarjeve buxhetore, shohim se kjo komunë ka pasur një trend konstant të ndarjeve buxhetore. Në anën tjetër shpenzimet kapitale, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale do të kenë një rënie të lehtë në vitin 2013.

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2012



Sa i përket planifikimit dhe vlerësimit të të hyrave dhe shpenzimeve, Instituti GAP nuk ka mundur të ketë qasje në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014- 2016 të Rahovecit.

## **Metodologjia e hartimit të raportit**

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe kampanjave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të respektueshme për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Rahovecit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulumtimeve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Instituti GAP përkrahët nga:**



**Ky projekt është mbështetur nga:**

